

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës – Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PER KUALIFIKIM

(Ky proces verbal ishte per efekt publikimi bashke me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURES: “SHERBIME PROJEKTIMI –RIKONSTRUKSION I RRUGËVE AUTO. “KODËR BOJË - BUSHAT, KODËR BOJË - MARDHNAQ”, “QERRET”, “KORTHFULË”

KODI PERKATES NË FIALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 72224000-1 - Shërbimet e konsulencës për menaxhimin e projekteve, 71241000-9-Studim i realizueshmerise, shërbime konsulence, analiza,

1. VLERA E FONDIT LIMIT: 6.243.333,00 (Gjashte milion e dyqind e dyzete e te mije e treqind e tridhje e tre) lekë.

Afati i shërbimeve do të jetë për një periudhë **60 ditë**.

Në zbatim të urdhrit të grupit të specifikimeve Nr. ____ Date ____ 2026, të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, "Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përlllogaritjen e Vlerës Limit për objektin e mësipërm, të planifikuar për t'u kryer në programet e investimeve.

Grupi i specifikimeve teknike pasi u njoh me objektin e prokurimit, programoi punën për përlllogaritjen e vlerës së projektit dhe hartimit të specifikimeve teknike duke u mbështetur në këto dokumenta:

- VKM. Nr. 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave per shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".
- Investime të kryera nga autoritete kontraktore në objekte të ngjashme.
- Buxhetin e Bashkise Pukë.

PËRLLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS

Për llogaritjen e vleres së projektit grupi i punës, është mbështetur në Vendimin VKM. Nr. 354, datë 11.05.2016.

Mbështetur në VKM. Nr.354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim", Seksioni IV “STRUKTURAT E TRANSPORTIT DHE QARKULLIMIT”, Neni 45, Grupet tarifore dhe klasifikimi i tyre, iii.

Grupi III tarifar: pika a) “Rrugë ne terren të thyer në kushte të vështira të terrenit dhe të kullimi të ujrave, rrugë jashtë qendrave të banimit me pika të veçanta detyrimi ose në terren të thyer”; duke ju referuar preventivit orientues të hartuar për objektin “Rikonstruksion i rrugëve auto. “Kodër Bojë - Bushat, Kodër Bojë - Mardhnaq”, “Qerret”, “Korthpulë”, me “kosto të llogaritshme” 518,371,004.40 (leke pa tvsh) e cila i përket vlerës totale për realizimin e punimeve sipas preventivit orientues paraparak, në Tabelën 12 “Tabela shoqëruese e tarifave - Strukturat e transportit (Qarkullimi)”, gjejmë:

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhenenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/entikontraktor Bashkia Pukë ka hartuar process verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen e poshtë:

Sipas specifikimeve bashkangjitur të hartuara, vendosur dhe përlllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: "Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike (termat e referencës) dhe përlllogaritjen e fondit limit", mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"

I. KRITERET E VEÇANTA TEKUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik "

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriterë duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 1.600.000 lekë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Percaktimi i vleres se kerkuar argumentohet si me poshte:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme është bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe mbështetet në nenin 77, pika 3, e LPP, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 43,b

Percaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin 9920 datë 19.05.2008, Për Procedurat Tatimore, neni 64 Deklarata Tatimore.

Shenim: Duke qene se aktet ligjore dhe nënligjore parashikonënjë marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet te argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

2.2.2 Operatorët ekonomike duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024, 2025 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e percaktimeve në përputhje me Ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar, i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në nenin 77, pika 3, të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.

2.2.3 Operatorët ekonomike duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2025 referuar ligjit nr. 9632, date 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

(Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomike, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Shenim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Kjo kërkesë bazohet në Ligjin nr.9632, date 30.10.2006, Për sistemin e taksave vendore i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

2.3 Aftesiteteknikedheprofesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontrates, në një vlerë jo më të vogël se 1.600.000 lekë,

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomike duhet të paraqesin dëshmitë e më poshtme:

- a) përpërvojen e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të leshuara nga një ent public për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati I përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotesuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) përpërvojen e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturave tatimore të shitjes, të plotesuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, dhe të deklaruar në organet tatimore,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën,

prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 1,600,00 lek ,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Duke parë vlerën e fondit limit për këto objekt mendojmë që marzhi i përcaktuar vendoset për të demonstruar që op.ekonomik kanë furnizime të ngjashme të kësaj natyre dhe jep garanci për realizimin e kontratës sipas specifikimeve dhe afatit të realizimit.Nuk e kalon vlerën e përcaktuar në ligj.Vlera e ngjashme nuk cenon asnjë op.ekonomik pasi është e perballueshme dhe në propozicion të plotë me objektin

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme në fushën e projektimit të leshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe të gjitha entet e tjera përgjegjëse:

PROJEKTUES KONSTRUKTOR:

Kategoria 3.a(1) – Projekte objekte civile –industriale-turistike.

Kategoria 3.b(2) – Projekte objekte civile –industriale-turistike.

PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE:

Kategoria 5.b – Projektimfurnizim me ujë – kolektorëshkarkimi

Kategoria 5.c – Projektim ujesjellës kanalizime urbane - rurale.

Kategoria 5.d – Projektim vepra ujitje - kullimi - impiante vaditëse – diga të vogla (ato që nuk plotësojnë kushtin e digave të mëdha) – damba, sifona, kaskada, kapërderdhëse, rrymëshpejtues, prize, baraze, porta, tombino.

PROJEKTUES RRUGË – HEKURUDHA:

Kategoria 6.a – Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.

Kategoria 6.b – Projektim rrugëq urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore.

PROJEKTIM URA DHE VEPRA ARTI:

Kategoria 7.a– Projektim ura dhe vepra arti të vogla deri më 10 m.

Kategoria 7.b – Projektim ura dhe vepra arti mbi 10 m.

Kategoria 7.c– Projektim ura/viadukte me hapësira të mëdha drite, ura të varura, ura me sisteme të pacaktuara statikisht dhe sisteme të tjera speciale.

PROJEKTUES GJEODET:

Kategoria 8.a - Rilevime inxhinierike.

Kategoria 8.b - Rilevime inxhinierike kadastrale.

Kategoria 8.d - Bazamente gjeodezike.

PROJEKTUES GJEOLOG:

Kategoria 9.a – Studime /Vlersime gjeologo inxhnierik i truallit për objekte civile

Kategoria 9.d - Studime /Vlersime gjeologo inxhnierik i truallit për troje të buta dhe shpate me qendrueshmeri të ulët.

PROJEKTUES SINJALISTIKE:

Kategoria 11.a –Projektim sinjalistike jo ndricuese ne rrruge lokale,rruge urbane dytesore,interurbane dytesore,sheshe e parkime

Kategoria 11.d – Projektim sinjalistike ndricuese ne infrastrukture

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT ose institucione të tjera të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKMnr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe në Vendimnr. 943, datë 28.12.2016 për disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve tëzbatimit në ndërtim"

Argumentimi:

PROJEKTUES KONSTRUKTOR: Kërkohet për llogaritjet strukturore të veprave të artit/rrugore strukturave mbajtëse dhe pritëse.

PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE: Kërkohet për arsyen se projektuesi do të realizojë projektin për drenazhimin e ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore nëpërmjet kanaleve, tombinove, drenazheve, urave, etj..

PROJEKTUES RRUGË - HEKURUDHA: Kërkohet për hartimin e projekteve të rrugëve sipas detyrës së projektimit.

PROJEKTIM URA DHE VEPRA ARTI: Kërkohet për projektimin e intersektimeve të ndryshme, përgajtë rrugës që do të projektohen.

PROJEKTUES GJEODET: Për hartimin e plan rilevimit të terreneve që do të zhvillohen.

PROJEKTUES GJEOLOG: Për hartimin e raportit gjeologo sizmik që do të zhvillohet

PROJEKTUES SINJALISTIKE: kerkohet per hartimit te planit te vendosjes se sinjalistikes rrugore sipas legjislacioneve ne fuqi.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesemarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

- PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE. 1
- PROJEKTUES RRUGE - HEKURUDHA. 1
- PROJEKTUES GJEODET. 1
- PROJEKTUES TE SINJALIZIMIT RRUGOR. 1
- PROJEKTUES GJEOLOG

Per stafin e mesiperm Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

Kontratat individuale të punes (të vlefshme), Licencat profesionale, Diplomë .

Shënim:Ky kriter (2.3.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Ne bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës:

Personeli i mësipërm kërkohej në bazë të vlerësimit të natyrës së objektit dhe projektit që do të realizohet Konkretisht:

- PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE kërkohej për arsyen se do të realizojë projektet e kanalizime (KUB).

- PROJEKTUES RRUGE - HEKURUDHA. Kërkohet për arsyen se do të realizojë projektin e rrugës object prokurimi në bazë të kushteve teknike të projektimit me të gjitha elementet përbërës të një projekti.
- PROJEKTUES GJEODET kërkohet për arsyen se do të realizojë rilevimin topografik të rrugës ekzistuese.
- PROJEKTUES TE SINJALIZIMIT RRUGOR. Kërkohet për arsyen se, do të realizojë projektin e sinjalistikës rrugore.
- PROJEKTUES GJEOLOG. Kërkohet për arsyen se, do të realizojë raportin gjeologo sizmik.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 4 persona (Numri prej 4 personash përfshin personelin kryesor si dhe stafin mbështetës) në listpagesa sipas formularëve standart për sigurimet, për muajin e fundit, të ciliti takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës. Dokumenta të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit në fuqi.

Shënim: Ky kriter (2.3.4) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, tënenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomike të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.3.5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e më poshtme

- Pajisjet gjeodezike, total station, gps.

Shënim: Ky kriter (2.3.5) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit

kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, tënenittë 77, të ligjit nr. nr. 162, date 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomike të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Paisjet gjeodezike, total station, gps, janë të nevojshme sepse me anë të tyre do të bëhët rilevimi topografik i zones ku do të shtrihet investimi.

2.3.6. Operatori ekonomik ofertues në përlllogaritjen e ofertës, duhet ti referohet mënyrës së përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim" duke iu referuar grupit tarifar të tretë për fazën e pestë dhe të gjashtë si dhe vlerës së parashikuar të punimeve të kontratës për të cilën do të realizohet studim-projektimi.

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jete brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor ka vendosur këtë kriter në zbatim të nenit 36 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe dispozitave të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", sipas të cilave specifikimet teknike dhe kërkesat e dokumenteve të tenderit duhet të garantojnë që shërbimi i kërkuar të realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet teknike të detyrueshme.

Për shërbimet e projektimit, VKM nr. 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim", e ndryshuar, përcakton metodologjinë dhe kufijtë minimalë e maksimalë të tarifave profesionale që duhet të zbatohen. Konkretisht, neni 7/1 i këtij vendimi parashikon se tarifat për këto shërbime nuk mund të jenë jashtë kufijve minimalë dhe maksimalë të përcaktuar në Manual.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë të hartojnë ofertën ekonomike duke iu referuar Grupit Tarifar III, fazës së pestë dhe të gjashtë, mbi bazën e vlerës së parashikuar të punimeve, me qëllim garantimin e respektimit të tarifave të detyrueshme të miratuara me akt normativ, sigurimin e cilësisë së shërbimit të projektimit, shmangien e ofertave të përlllogaritura në kundërshtim me legjislacionin dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.

Mosrespektimi i kësaj metodologjie sjell paraqitjen e një oferte në kundërshtim me legjislacionin e posaçëm që rregullon tarifat e projektimit dhe, për këtë arsye, përbën shkak për mospranimin/skualifikimin e ofertës, pasi oferta nuk është hartuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe dokumentet e procedurës.

II. Argumentimi I specifikimeve teknike

Detyra e projektimit&Termat e references dhe procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, të hartuara, vendosur dhe përlogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: "Grupi i punës për hartimin e specifikimeve të knike dhe përlogaritjen e fondit limit", mbështetur në Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" janë bashkëngjitur.

Specifikime teknike/termave të referencës/detyrës së projektimit, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruanë DT, me të dhënat e mëposhteme:

Njesia e Prokurimit